

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“D&H” SHPK

Sot, më datë 1.9.2021, palët Z.Illir Halilaj dhe Zj. Flutura Sulika bien dakord që sëbashku të themelojnë një shoqëri tregtare me qëllim kryerjen e aktivitetit ekonomik të përshkruar më poshtë dhe për të ndarë mes tyre fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqërisë. Palët vendosën që kjo shoqëri të rregullohet dhe të funksionojë sipas dispozitave në vijim të këtij Statuti.

THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

Neni 1

Ortakët

1.1 Ortakët themelues të shoqërisë janë:

- Z. Ilir HALILAJ, shtetas shqiptar, lindur më 19.4.1970, mbajtës i kartës së identitetit nr. Personal H00419087T;
- Zj. Flutura SULIKA, shtetase shqiptar, lindur më 4.9.1988, mbajtëse e kartës së identitetit nr. Personal I85904045D;

Neni 2

Emri

2.1 Emri i shoqërisë është “D&H” SHPK (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

Neni 3

Forma Ligjore

3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Baza ligjore



4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji i Shoqërive Tregtare”) dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Kohëzgjatja e Veprimitarisë

5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 6

Selia/Adresa e Regjistruar

6.1 Selia e Shoqërisë është në adresën, Linzë, Bashkia Tiranë, Njësi me nr. Pasurie 219/21+3-N4.

6.2 Administratori mund të krijojë NIPT-e sekondare të Shoqërisë.

Neni 7

Objekti

7.1 Objekti kryesor i Shoqërisë është import, eksport, tregtim i artikujve të ndryshëm, pastičeri, prodhime dhe tregtim me shumicë & pakicë të ëmbëlsirave dhe brumërave, import & eksport të artikujve të ndryshëm ushqimore. Fabrika Ushqimore. Ambalazhe te ndryshme.

7.2 Shoqëria mund të kryejë me qëllim arritjen e objektivave të biznesit të shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksion në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

7.3 Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet ndihmëse ose të lidhura, duke përfshirë dhe eksportin, si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe të favorshme për të arritur qëllimin e biznesit të Shoqërisë në përputhje me ligjin.

7.4 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

Neni 8

Kapitali

8.1 Kapitali i Shoqërisë në datën e nënshkrimit të këtij Statuti është 1.000,00 (njëmijë) Lek.

8.2 Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 2 (dy) kuota, secili prej ortakëve gëzon një kuotë të barabartë si më poshtë:

- a. Ilir Halilaj, zotërues i një kuote prej 500,00 Lek që përfaqëson 50 % të kapitalit të Shoqërisë;
- b. Flutura Sulika, zotërues i një kuote prej 500,00 Lek që përfaqëson 50 % të kapitalit të Shoqërisë;

Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet mbi transferimin

9.1 Transferimi i kuotave tek palët e treta ose ndërmjet ortakëve mund të bëhet vetëm me anë të një kontrate me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet në vijim.

9.2 Nëse njeri nga Ortakët (Ortaku Shitës) do të transferojë të gjitha apo një pjesë të kuotave që ka në zotërim (Kuotat në Shitje) një personi të tretë, ofertën e te cilit ai e ka përzgjedhur si me të kënaqshmen (Blerësi i Ofruar), atëherë ky ortak do të njoftojë menjëherë Ortakët e tjerë dhe Administratorin e Shoqërisë (Njoftimi për Shitje) me postë rekomande shoqëruar dhe me një njoftim në adresën e postës elektronike të Ortakut (nëse kanë), në të cilën të përcaktohen kushtet e transferimit të ardhshëm të kuotave të tij. Njoftimi për Shitje duhet të përfshijë ndër të tjera (i) emrin e përfituesit të transferimit, (ii) çmimin që do të paguhet për kuotat. Ortakët e tjerë brenda (30) tridhjetë ditëve nga dita që kanë marrë Njoftimin për Shitje mund të refuzojë transferimin e kuotave tek Blerësi i Ofruar me anë të një njoftimi me shkrim të dërguar, me postë rekomande Ortakut Shitës dhe Administratorit të Shoqërisë brenda 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e marrjes të Njoftimit të Shitjes dhe në këtë njoftim t'i bëjnë Ortakut Shitës një ofertë për blerjen e Kuotave në Shitje. Ortaku Refuzues nuk mund të bëjë një ofertë të pjesshme, apo të ofrojë që të blejë Kuotat në Shitje për një çmim blerjeje më të ulët sesa ai i ofruar nga Blerësi i Ofruar apo me kushte me te disfavorshme sesa kushtet e ofertës së Blerësit të Ofruar. Nëse Ortaku Refuzues nuk bën ofertë për blerjen e Kuotave në Shitje në kushtet e parashikuara në këtë seksion dhe brenda afatit (45) ditor që nga dita që i është bërë Njoftimi për Shitje, atëherë Ortaku Shitës ka të drejte që të shesë Kuotat në Shitje çdo personi tjetër me kusht që kjo shitje të mos bëhet me çmim më të ulët dhe kushte me te favorshme sesa ato të ofruara nga Blerësi i Ofruar, përndryshe kjo shitje do të konsiderohej e pavlefshme. Kështu, për të shmangur çdo dyshim, Ortaku Shitës sa herë që do të ofrojë për shitje kuotat e tij me çmim apo me kushte më të favorshme sesa ato të njoftuara Ortakut tjetër, këtë ofertë për shitje duhet që t'ia drejtojë me përpara këtij Ortaku për t'i dhënë mundësinë këtij të fundit që të ushtroje te drejtën e tij të refuzimit fillestar.

Neni 10

Zmadhimi i Kapitalit

10.1 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet duke iu ofruar për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë. Nëse kuotat reja do t'u ofrohen për nënshkrim një pale të tretë atëherë duhet miratimi me unanimitet i Asamblesë së Ortakëve.

10.2 Kontributet e ortakëve mund të konsistojnë në të gjitha format e aktiveve të lejuar nga ligji, duke përfshirë edhe kontributet në natyrë.

10.3 Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet financime me pagesa, me interes ose pa interes, qoftë si kontribute në kapital ose jo, edhe objekt rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

10.4 Mënyra e rritjes së kapitalit në lidhje me metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga Ortakët do të vendoset rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të përfshijnë ndër të tjera dënimet dhe pasojat për një ortak në rast të mos-pagesës së kontributit të rënë dakord në afatin dhe shumën e caktuar duke përfshirë, po pa u kufizuar, (i) zvogëlimin proporcional të pjesës të ortakut në Shoqërisë, (ii) shitjen e detyruar të kuotave të ortakut në Shoqëri, (iii) përcaktimit, në bazë të një vlerësimi profesional ose formule, të vlerës së cilësdo pjesë të ortakut që është paguar, dhe shitjen e detyruar të asaj pjese në vlerën e përcaktuar.

Neni 11

Zvogëlimi i Kapitalit

11.1 Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji shqiptar i zbatueshëm.

STRUKTURA DREJTUESE

Neni 12

Asambleja e Ortakëve

12.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.

12.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve ("Asambleja e Ortakëve"), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

12.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendos për çështjet e mëposhtme:

- a. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;

- b. të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorit të Shoqërisë;
- c. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
- d. vendosë për prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- e. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
- f. të miratojë raportet vjetore dhe bilanci dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
- g. të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- h. të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë e Shoqërisë të cilat përfaqësojnë më shumë se 5% të aktiveve të saj;
- i. të vendosë pagën e Administratorit;
- j. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- k. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
- l. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
- m. të vendosë marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria;
- n. të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje Asamblesë së Ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.

Neni 13

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

13.1 Me përjashtim të rasteve kur ligji kërkon detyrimisht një shumicë më të ulët, të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve kërkojnë miratimin e votave të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë në çdo kohë.

Neni 14

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

14.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë të paktën katër herë në vit, një herë në çdo tre muaj, në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim. Në çdo rast, Shoqëria do thërritet brenda muajit qershor të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat e saj financiare të vitit të mëparshëm financiar.

14.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori edhe nëse:

- a. sipas bilanci vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

b. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

14.3 Më tej, secili prej ortakëve të Shoqërisë mund t'i kërkojnë administratorit me shkrim apo me postë elektronike thirrjen e asamblesë së ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë.

14.4 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga administratori, i cili duhet t'u dërgohet përfaqësuesve të ortakëve me letër rekomande ose faks ose postë elektronike (e-mail) jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar për asamblenë. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t'u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.

14.5 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligji të Shoqërive Tregtare.

Neni 15

Vendimet e miratuara në Asamblesë Ortakëve

15.1 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave me të drejtë vote të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë në çdo kohë.

15.2 Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërish në përputhje me parashikimet e Nenit 14 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i Asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.

15.3 Kur Asambleja e Ortakëve nuk është thirrur sipas formaliteteve të ligjit ose këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

15.4 Ortakët njohin dhe pranojnë të drejtën për të vendosur në lidhje me Shoqërinë me shkrim. Vendimet e propozuara, së bashku me dokumentet që mbështesin vendimet do t'i dërgohen ortakëve me postë të thjeshtë, postë korrier, faks apo e-mail. Ortakët duhet të vendosin mbi vendimet brenda 15 ditëve nga data që vendimi me shkrim i është dërguar ortakëve. Ortakët miratojnë vendimet duke i kthyer një kopje të nënshkruar të vendimit me shkrim Administratorit të Shoqërisë. Ortaku që ka kundërshtuar duhet ta shprehë kundërshtimin e tij/saj në lidhje me vendimin me shkrim dhe t'ia dërgojnë Administratorit të Shoqërisë. Vendimi me shkrim do të konsiderohet i miratuar në qoftë se miratohet me unanimitet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.

15.5 Ortakët mund të marrin vendime me shkrim në mungesë të formaliteteve të parashikuara më sipër në pikën 15.4 vetëm nëse të gjithë ortakët pranojnë të miratojnë këtë vendim. Për këtë

qëllim, të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë vendime të ndryshme por analoge, një kopje e nënshkruar e së cilës duhet t'i dërgohet Administratorit të Shoqërisë.

Neni 16

Procesverbalet e Asamblesë së Ortakëve

16.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të Asamblesë së Ortakëve. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit si dhe ti bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

16.2 Procesverbali i Asamblesë së Ortakëve nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Kryetari i Asamblesë së Ortakëve do të zgjidhet nga ortakët para fillimit të asamblesë, ndërsa mbajtësi i procesverbalit do të caktohet nga kryetari i Asamblesë së Ortakëve. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që procesverbali të mbahet nga një noter publik në të cilin rast nuk është e nevojshme caktimi i mbajtësit të procesverbalit dhe nënshkrimi i procesverbalit nga kryetari i mbledhjes. Ekstraktet e procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve për qëllim depozitimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit janë të vlefshme nëse nënshkruhen nga të gjithë ortakët pjesëmarrës në Asamblenë e Ortakëve ose edhe vetëm nga Administratori i Shoqërisë por nëse përmbajtja e tyre konfirmohet në përputhje me procesverbalin nga një noter publik.

Neni 17

Përjashtimi nga e drejta e votës

17.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Ortakëve merr vendime për:

- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c. ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
- d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja
- dh. çdo rast tjetër të parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

17.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 18

Administrimi i Shoqërisë



- 18.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator, i emëruar nga Asambleja e Ortakëve.
- 18.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e Shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj dhe me këtë Statut i takojnë Asamblesë së Ortakëve.
- 18.3 Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve publike;
 - b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - c. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - e. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
 - f. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
 - g. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
 - h. administratori ka të drejtë të ngrëjë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktoj arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
 - i. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - j. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
 - k. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim Asamblesë së Ortakëve;

l. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;

m. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.

n. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

o. çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

18.6 Administratori i Shoqërisë duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim të përfaqësuesve ligjorë të të gjithë ortakëve për përfundimin e çdo marrëveshjeje ose çdo pune e cila e tejkalon shumën prej [100.000,00] (njëqindmijë) EURO ose ekuivalentin në Lekë apo në çdo monedhë tjetër dhe gjithashtu për përfundimin e transaksioneve vijuese pavarësisht vlerës së tyre:

i. shitjen dhe/ose hipotekimin dhe pengun mbi asetet e Shoqërisë;

ii. themelimin e shoqërive të reja në të cilën Shoqëria do të zotërojë kuota ose interesa të pronësisë;

iii. përfundimin e marrëveshjeve për patentat/licencat/pronësinë industriale ose çdo marrëveshje tjetër për transferimin e teknologjisë, për njohuritë teknike dhe/ose përdorimin e të drejtave;

iv. themelimin e degëve të Shoqërisë.

18.7 Për efekt të përfaqësimit dhe të kryerjes së veprimeve të Shoqërisë në lidhje me bankat apo me institucione të tjera financiare, brenda apo jashtë vendit, Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratori i saj dhe gjithashtu nga personat e tjerë të autorizuar për të përfaqësuar Shoqërinë, siç përcaktohet në Aneksin 1 të bashkangjitur më poshtë, duke iu nënshtruar kufizimit se për kryerjen e rregullt të të gjitha veprimeve dhe përfaqësimit përkatëse të parashikuara në nenin 18.7, një prej përfaqësuesve të Shoqërisë sipas përcaktimit në Aneks 1 më poshtë, përfshirë edhe Administratorin, do të nënshkruajnë bashkarisht në emër të Shoqërisë.

18.8 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve.

18.9 Palët bien dakord që fillimisht administrator i shoqërisë të për një afat 2 vjeçar të caktohet:

Z. Ilir HALILAJ, shtetas shqiptar, lindur më 19.4.1970, mbajtës i kartës së identitetit nr. Personal H00419087T.

Neni 19**Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

19.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.

Neni 20**Viti Financiar**

20.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 21**Bilanci. Mbajtja e Llogarisë**

21.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.

21.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.

21.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguroese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 22**Largimi dhe përjashtimi Ortakut**

22.1 Ortaku mund të largohet nga Shoqëria nëse ortaku tjetër ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratori duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për njoftimin e largimit si më sipër, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

22.2 Asambleja e Ortakëve mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij sipas statutit ose nëse ekziston të paktën një prej shkaqeve të arsyeshme, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:



- a) Ortaku me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme Shoqërisë ose ortakut tjetër;
- b) Ortaku me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) Ortaku përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç) Ortaku me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të Shoqërisë.

22.3 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

Neni 23

Likuidimi

23.1 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë të prishë Shoqërinë me vendim të marrë e unanimitetin e të gjithë ortakëve.

23.2 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve do të caktohet një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.

23.3 Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

Neni 24

Ndryshimet në Statut

24.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 25

Dispozita Përfundimtare

25.1 Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, secila prej tyre me të njëjtën vlerë ligjore.

Ortakët e Shoqërisë

ILIR HALILAJ

ILIR HALILAJ

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of a large, sweeping 'H' shape with a horizontal line crossing it.

FLUTURA SULIKA

Flutura Sulika

A handwritten signature in blue ink, featuring a cursive 'F' followed by a horizontal line and a small flourish.